

01 Nr. 733/24 Dt. 02.12.2024

Në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 05.07.2024, **Federata e Futbollit e Kosovës** (tutje referuar si “FFK”), dhe **Komuna e Prizrenit** (tutje referuar si “Komuna”), palët me të dhënat e shënuara sikur mëposhtë:

Federata e Futbollit e Kosovës, me seli në rr. 28 Nëntori, nr.171., me numër të regjistrimit 5100477-9, përfaqësuar nga **z. Agim Ademi – Kryetar**, në njërën anë

dhe

Komuna e Prizrenit, me seli në rr. Remzi Ademaj, p.nr., përfaqësuar nga **z. Shaqir Totaj**, Kryetar i Komunës,

Hyrje:

FFK është organizatë sportive e pavarur joqeveritare dhe jo fitimprurëse, FFK organizon. Mbikëqyrë dhe udhëheq garat e futbollit të të gjitha kategorive dhe është prinare e të gjitha të drejtave, për të gjitha ndeshjet e futbollit në Republikën e Kosovës.

FFK dhe Komuna e Prizrenit me datë 05.07.2024 kanë nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit dhe realizimin e investimeve në fushën e stadiumit në fshatin Kabash-Has në Komunën e Prizrenit. Mirëpo, duke pasur parasysh nevojën të intervenohet në punët e fazës finale, përkatësisht në punimin e fushës faza e dytë në punët finale për punët përgaditore, Punët e Germimit dhe zhavorit të fushës, Punët tjera dhe Punët e Ujitjes. Komuna e Prizrenit me datë 12.11.2024, ka paraqitur kërkesën e saj që të intervenohet në punët finale, sipas specifikave të përcaktuara me këtë Aneks Marrëveshjeje dhe Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 05.07.2024.

Në bazë të diskutimeve të mëparshme, në shprehje të vullnetit të tyre të lirë, e në pajtim me kompetencat e tyre statutare, Ligjin e Sportit dhe Ligjet tjera të aplikueshme, palët e lartshënuara, lidhin këtë Aneks Marrëveshjeje konform kushteve të caktuara si më poshtë:

ANEKSI I I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

Neni 1

1.1. Neni 5.2, i Memorandunit të Bashkëpunimit të datës 05.07.2024, i shtohet paragrafi 5.2.1. me tekstin si në vijim:

“Komuna e Prizrenit është e obliguar që të punët finale faza dytë si punët përgaditore, Punët e Germimit dhe zhavorit të fushës, Punët tjera dhe Punët e Ujitjes , sipas paramasës dhe parallogarisë së bërë.”

1.2. Palët janë pajtuar që neni 5.2., paragrafi 2, i Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 07.05.2024, ta zëvendësojnë me tekstin si në vijim:

“Pozicionet e shënuara në nenin 5.2., paragrafin 1, dhe nenin 1.1. të këtij Aneksi, nuk mund të tejkalojnë vlerën maksimale prej 249,122.10 € dhe paguhen nga Komuna e Prizrenit”.

1.3. Palët janë pajtuar që neni 5.3., i Memorandumit të Bashkëpunimit, të datës 07.05.2024, ta zëvendësojnë me tekstin si në vijim:

“Procedurat e përzgjedhjes së kompanisë/ve për kryerjen e të gjitha punëve nga pika 5.1. dhe 5.2., dhe nenin 1.1. të këtij Aneksi, do të udhëheqën nga FFK-ja për shkak të specifikave të projektit dhe përvojës së kësaj të fundit në realizimin e projekteve të njëjta në të gjithë Kosovën, ndërsa pagesa do të bëhet direkt tek kompania e përzgjedhur nga secila palë pas aprovimit përkatës nga organi i tij mbikëqyrës”

1.4. Pjesa tjetër e Nenit 5 dhe neneve tjera, të Memorandumit të Bashkëpunimit mbeten të pandryshuar.

Neni 2

2.1. Palët konfirmojnë se pasi kanë lexuar të gjitha nenet e kësaj Aneksi Kontrate kontrate në shprehjen e vullnetit të lirë e nënshkruajnë këtë aneks kontratë pa imponime apo ndikime të jashtme të çfarëdo lloji dhe këtë e dëshmojnë me nënshkrimet e tyre.

2.2. Nenet e ndryshuara nga kjo Aneksi Kontratë do të zbatohen në marrëdhëniet ndërmjet FFK-së dhe Komunës që nga momenti i nënshkrimit të së njëjtës.

2.3. Marrëdhëniet ndërmjet Palëve do të rregullohen nga Memorandumi i Bashkëpunimit i datës 05.07.2024, dhe këtë Aneks.

2.4. Ky Aneks është përpiluar në 2 (dy) kopje identike, një kopje për secilën nga Palët.

Prishtinë, më [25.11.2024]

Federata e Futbollit e Kosovës
z. Agim Ademi, Kryetar



Komuna e Prizrenit
z. Shaqir Totaj, Kryetar

